REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA I FUSHË-KOSOVËS - OPSTINA KOSOVO POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.i/Br.sv. 370
Data/Datum 19. 11. 2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPSTINA KOSOVO POLJE

Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e nëntë e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e mbajtur me datën 29.09.2026, në ora 10:00h, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vlonjat Hasani - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Festim Pllana, Daut Krasniqi, Kushtrim Mirena, Kosovar Ademi, Besarta Qadraku, Filloreta Musaj, Arlinda Mekolli, Rrahim Sogojeva, Hajredin Mjeku, Afrim Dumani, Laureat Gojnovci, Mirlinda Krasniqi, Jetmir Berisha, Burim Berisha, Saranda Sllamniku, Vjosa Kida Hyseni, Ali Topalli, Rrahim Tërnava, Valon Murseli, Ermal Dumani, Dardane Sogojeva Shala, Migjen Kolshi, Aida Alimi, Suhat Ademi, Dashnim Bajrami, Ali Ismaili, Driton Ademi, Gjelbrim Halili dhe Radoman Doderovic.

Mungojnë: Etnik Berjani.

Prezentë nga Ekzekutivi i Komunës: Valon Prebreza - Kryetari i Komunës, Bardhyl Koiçiçi - Drejtor për Buxhet dhe Financa, Sabri Xhigoli - Drejtor i Arsimit, Ylber Kelmendi - Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport, Durim Hajra - Drejtor i Inspeksionit dhe Vildane Latifi - Drejtoresha e Administratës.

Të tjerë: Përfaqësues të Shoqërisë Civile dhe Media.

REND DITE

1. Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 27.08.2026.
2. Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 02.09.2026.
3. Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 17.09.2026.
4. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
5. Propozim për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029 dhe Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë Kosovës për vitin 2027.
6. Propozim për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 67, të datës 24.02.2026.
7. Propozim për rishqyrtimin e vendimit dhe ndryshim-plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa.
8. Propozim për ndryshim-plotësimin e përbërjes së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
9. Propozim për rishqyrtimin e ndryshim-plotësimit të vendimit Nr. 15, të datës 28.01.2026.
10. Shqyrtimi i dytë dhe ndryshim-plotësimi i Rregullores për Taksa Komunale.

11. Shqyrtimi i dytë i Projekt-Planit Lokal për avansimin e të drejtave të komuniteteve romë dhe ashkalinjë të Komunës së Fushë Kosovës për 2026-2029.
12. Informatë për performancën e Komunës së Fushë Kosovës në vitin 2025.
13. Propozim për shfuqizimin e vendimit Nr. 267, të datës 03.09.2026, sipas shkresës të Ministrisë së Financave Nr. 1758-1/2026, të datës 21.09.2026.
14. Propozimit për transferimin - rialokimin e mjeteve financiare për asfaltimin e rrugës 'Ejup Gashi'.
15. Propozim për transferimin - rialokimin e mjeteve financiare për arsim në nën-programet buxhetore të shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës.
16. Propozim për transferimin - rialokimin e mjeteve financiare për nën-programin Infrastruktura Rrugore.
17. Propozim për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 75,000€, për realizmin e projektit dy vjeçar për ndërtimin e objektit me karakter shoqërorë 'Shtëpi për të pame' me objekte përcjellëse në Fushë-Kosovë në lagjen e komuniteteve 029.
18. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndetje të pranishëm, drejtor, ekzekutiv dhe media. Po fillojmë mbledhjen e nëntë të rregullt të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, po fillojmë me leximin e pikave të rendit të ditës, pika e parë është: Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e datës 27.08.2026, pika e dytë është: Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e datës 02.09.2026, pika e tretë është: Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e datës 17.09.2026, pika e katërt është: Pyetje dhe përgjigje parlamentare, pika e pestë është: Propozim për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029 dhe Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2027, pika e gjashtë është: Propozim për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 67, të datës 24.02.2026, pika e shtatë është: Propozim për rishqyrtimin e vendimit dhe ndryshim-plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, pika e tetë është: Propozim për ndryshim-plotësimin e përbërjes së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, pika e nëntë është: Propozim për rishqyrtimin e ndryshim-plotësimit të vendimit Nr. 15, të datës 28.01.2026, pika e dhjetë është: Shqyrtimi i dytë dhe ndryshim-plotësimi i Rregullores për Taksa Komunale, pika e njëmbëdhjetë është: Shqyrtimi i dytë i Projekt-Planit Lokal për avansimin e të drejtave të komuniteteve romë dhe ashkalinjë të Komunës së Fushë-Kosovës për 2026-2029, pika e dymbëdhjetë është: Informatë për performancën e Komunës së Fushë-Kosovës në vitin 2025 dhe pika e trembëdhjetë: Të ndryshme. Kemi rekomandime që kanë ardhur nga dy komitetet e përherëshme, rekomandimi i parë është: 1. Propozimi për shfuqizimin e vendimit Nr. 267, të datës 03.09.2026, sipas shkresës së Ministrisë së Finanacave me Nr. 1758-1/2026, të datës 21.09.2026. 2. Propozimi për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për asfaltimin e rrugës 'Ejup Gashi'. 3. Propozimi për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për arsim në nën - programet buxhetore të shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës. 4. Propozim për transferimin /

rialokimin e mjeteve financiare për nën - programin 'Infrastruktura Rrugore', këto janë rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa. Rekomandimi nga Komiteti për Komunitete është: 5. Propozim për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 75,000.00€, për realizmin e projektit dy vjeçar për ndërtimin e objektit me karakter shoqërorë 'Shtëpi për të pame' me objekte përcjellëse në Fushë-Kosovë në lagjen e komuniteteve 029. Po e hapi diskutimin për pikat e rendit të ditës dhe pikat shtesë.

Kosovar Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, pajtohemi me përmbajtjen e pikave të rendit të ditës dhe rekomandimet e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete.

Laureat Gojnovci: Përshëndetje për të gjithë, gjithmonë kemi dashur ta votojmë rendin e ditës të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës, mirëpo në çdo mbledhje vijnë pika shtesë, që na pamundësojnë ta votojmë rendin e dites. Lëvizja Vetëvendosje pikat shtesë nuk i ka votuar asnjëherë sidomos kur nuk kanë urgjencë, është bërë praktike e keqë, kjo puna për pikat shtesë. Sot e kemi buxhetin, një prej pikave më me rëndësi brenda vitit kalendarik dhe sot ju i sjellni përveç 13 pika të rregullta, edhe 5 pika tjera shtesë, kjo nuk është në rregullë, kështu që ne nuk i përkrahim këto pika jashtë rendit të ditës.

Migjen Kolshi: Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, përshëndetje për të gjithë, është bërë praktikë e keqë, kjo puna me pika shtesë, këto pika nuk kanë urgjencë, pika e arsimit nga Investimet Kapitale shkon në Mallëra dhe Shërbime, nëse kjo drejtori do të kishte vullnet për punë ato shkolla do të renovoheshin gjatë pushimit veror, por i bartin mjetet financiare në Mallëra dhe Shërbime për t'i paguar punëtorët me projekteve të 'Caritasit dhe Kosova Med', të cilët nuk punojnë. E njejta vlen edhe për Drejtorin e Infrastrukturës, që nese do donte të punonte ajo rrugë do të përfundonte më herët. Ne nuk i përkrahim asnjë nga këto pikat shtesë.

Ali Ismaili: Përshëndetje për të gjithë, nga fillimi i kësaj legjislature kam ngritur shqetësim që të mos sjellen pika shtesë, nuk është praktikë e mirë. Unë prita që drejtorët z. Sabri Xhigoli dhe z. Arianit Tërmkolli, të dalin këtu me një arsyeshmëri, pse i kanë sjellë këto pika jashtë rendit të ditës, ata nuk e morën mundin të dalin fare dhe mendojnë, që ne do t'i votojmë me dy rreshta fletë pa na elaboruar çfare investime do të bëhen në shkolla dhe cilat projekte, po i hjekim të investimet kapitale, pse nuk janë realizuar deri në këtë muaj, a na garantoni që mundeni me i realizuar këto kur mësimi është prezentë aty, si do të bëhet ai investim? Po na mungojnë planet e renovimit, këto veprime nuk janë në rregull, jam kundër pikave shtesë.

Driton Ademi: Përshëndetje për të gjithë, gjithmonë kam qenë kundër pikave shtesë në rendin e ditës, janë jashta procedurës i mohohet e drejta asambleistit që për shtatë ditë pune, ta shqyrtojë një material mbi bazën e të cilit do të vendosë, se a do të votojë pro apo kundër. Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, përmbajtja e një mbledhje të Kuvendit të Komunës, kalon nëpër Komitetet e Përherëshme, kur e sjellë një pikë shtesë, t'i po i'a mohon shqyrtimin Komiteteve të Përherëshme. Dua të them që Kryesuesi i Kuvendit dhe Sekretariati i Kuvendit, të vijnë deri të reduktimi i këtyre pikave shtesë, në mënyrë që të krijohet një kulturë në Kuvend dhe shqyrtimi i materialit të jetë adekuat.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë z. Driton Ademi, nëse nuk ka të tjerë që dëshirojnë të marrin fjalën, po i qesim rekomandimet në votim një nga një, rekomandimi i parë është: Propozimi për shfuqizimin e vendimit Nr. 267, të datës 03.09.2026, sipas shkresës së Ministrisë së Finanacave me Nr. 1758-1/2026, të datës 21.09.2026.
U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Propozimi për shfuqizimin e vendimit Nr. 267, të datës 03.09.2026, sipas shkresës së Ministrisë së Finanacave me Nr. 1758-1/2026, të datës 21.09.2026, hyn si pikë e rregullt për shqyrtim në rendin e ditës.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po e qesim në votim rekomandimin e dytë: Propozimi për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për asfaltimin e rrugës 'Ejup Gashi'.
U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Propozimi për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për asfaltimin e rrugës 'Ejup Gashi', hyn si pikë e rregullt për shqyrtim në rendin e ditës.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po e qesim në votim rekomandimin e tretë: Propozimi për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për arsim në nën - programet buxhetore të shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës.
U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Propozimi për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për arsim në nën - programet buxhetore të shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës, hyn si pikë e rregullt për shqyrtim në rendin e ditës.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po e qesim në votim rekomandimin e katërt: Propozimi për transferimin/rialokimin e mjeteve financiare për nën - programin 'Infrastruktura Rrugore'.
U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Propozimi për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për nën - programin 'Infrastruktura Rrugore', hyn si pikë e rregullt për shqyrtim në rendin e ditës.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po e qesim në votim rekomandimin e Komitetit për Komunitete: Propozimi për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 75,000.00€, për realizmin e projektit dy vjeçar për ndërtimin e objektit me karakter shoqërorë 'Shtëpi për të pame', me objekte përcjellëse në Fushë-Kosovë në lagjen e komuniteteve 029.
U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Propozimi për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 75,000€, për realizmin e projektit dy vjecar për ndërtimin e objektit me

karakter shoqërorë 'Shtëpi për të pame', me objekte përcjellëse në Fushë-Kosovë në lagjen e komuniteteve 029, hyn si pikë e rregullt për shqyrtim në rendin e ditës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E qesim në votim rendin e ditës së bashku me rekomandimet e komiteteve të aprovuara për shqyrtim.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për' asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje gjithsej tridhjetë anëtarë.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se u aprovua rendi i ditës së bashku me pesë rekomandimet e komiteteve, për shqyrtim në mbledhjen e sotme.

Pika e parë (1) - Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 27.08.2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E hapim diskutimin për tre ekstrakte të procesverbaleve, ndërsa votimin e tyre e bëjmë sipas radhës së tyre.

Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim për aprovim 'Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e datës 27.08.2026'.

Laureat Gojnovci: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, nuk e përkrahim për aprovim 'Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e datës 27.08.2026'.

Migjen Kolshi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës, nuk e përkrahim për aprovim 'Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e datës 27.08.2026', për arsye të mos publikimit të audioincizimeve.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Meqense nuk ka diskutime tjera, e qesim ne votim për aprovim 'Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e datës 27.08.2026'.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej gjashtëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje, gjithsej tridhjetë anëtarë.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se u aprovua 'Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e datës 27.08.2026'.

Pika e dytë (2) - Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës e datës 02.09.2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani vazhdojmë me 'Ekstraktin e Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës e datës 02.09.2026'.

Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim për aprovim 'Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e datës 02.09.2026'.

Laureat Gojnovci: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, nuk e përkrahim për aprovim 'Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e datës 02.09.2026'.

Migjen Kolshi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës, nuk e përkrahim për aprovim 'Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e datës 02.09.2026', për arsye të mos publikimit të audioincizimeve.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Meqense nuk ka diskutime tjera, e qesim ne votim për aprovim 'Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e datës 02.09.2026'.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje, gjithsej tridhjetë anëtarë.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se u aprovua 'Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e datës 02.09.2026'.

Pika e tretë (3) - Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës e datës 17.09.2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani vazhdojmë me 'Ekstraktin e Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës e datës 17.09.2026'.

Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim për aprovim 'Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e datës 17.09.2026'.

Laureat Gojnovci: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, nuk e përkrahim për aprovim 'Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e datës 17.09.2026'.

Migjen Kolshi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës, nuk e përkrahim për aprovim 'Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e datës 17.09.2026', për arsye të mos publikimit të audioincizimeve.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Meqense nuk ka diskutime tjera, e qesim ne votim për aprovim 'Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e datës 17.09.2026'.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje, gjithsej tridhjetë anëtarë.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se u aprovua 'Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e datës 17.09.2026'.

Pika e katërt (4) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani fjala është për ju asambleistë të nderuar/a.

Migjen Kolshi: Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, pyetja e parë është për Kryetarin e Komunës, mbledhjen e kaluar na premtoi se do ta vendosë banerin 'Kosova Pret' në monitorin e Komunës, ajo nuk ndodhi, pse? Kryetari i Komunës para pak kohe, e keni shkarkuar Drejtorin e Drejtorisë së Pronës, a do të vazhdosh njejtë me këtë standard, edhe për drejtora tjerë, në rast se fillojnë hetimet ndaj teje, a do të jep t'i dorëheqje? Për Drejtorin e Drejtorisë së Inspektoriatit, është duke u ndërtuar një objekt në rrugën 'Amir Elmazi' dhe ai që po ndërton, e ka uzurpuar komplet rrugën me rrethojë, këtë pyetje e kam parashtruar edhe në mbledhjen e kaluar, pse nuk po merren masa? Për Drejtoreshën e Drejtorisë së Zhvillmit Ekonomik, përfituesit e ndihmës 'Start-Up', e kanë pasur obligim të hapin një biznes në ARBK, a e kanë pasur obligim vetëm ta hapin atë biznes apo edhe ta aktivizojnë? Për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, a është e vërtetë se në renovimin e gjimnazit 'Hivzi Sylejmani', në paramasë nuk janë paraparë dyert e banjove dhe shkolla funksionon pa dyer të banjove?

Valon Murseli: Përshëndetje për të gjithë, po bëhen dy muaj që ne si Grup Parlamentarë I Partisë Demokratike të Kosovës, kemi dërguar 3 procese për auditim dhe nuk kemi përgjigje, kryetari në mbledhjen e kaluar tha që po të jap leje për auditimin e këtyre proceseve, sipas informatave është dhënë leje vetëm për auditimin e procesit të bursave, ndërsa për procesin e digjitalizimit të shkollave dhe procesin të hapur për kufizim të konkurencës, rritje të buxhetit pa asnjë bazë që është projekti për pompa termike, është rritur vlera dhe duhet ta dijmë pse është rritur? Sipas informacioneve nga grantet që janë dhënë tani, së fundmi është shpërblyer një nga anëtarët e kësaj zyre, familjari i tij me vlerë 2,000.00€, ky projekt është hartimi i projektit 'Lansscape për relativizimin e oborrit të një shkolle publike në Komunën e Fushë-Kosovës', mendoj që tendenca për t'i fshehur me kode përfituesit dhe tipet e projekteve është gabim, sepse e rritë dyshimin edhe më shumë. Kryetar i Komunë, keni folur shumë për nepotizmin dhe menduam se do të përfundon me dajën tuaj, çuditërisht edhe në konkursin e fundit pamë, persona të përzgjedhur familjar të ngushtë të Ekzekutivit të Komunës dhe ish-drejtor të pushtetit, është mirë të bëhet prerja, se këta drejtor, a kanë qeverisur mirë apo tani i keni hesapet me ta? Gjatë kësaj kohe i keni bërë disa udhëtime jashtë vendit, është mirë të na prezentoni agjendën e këtyre takimeve dhe rezultatet, sepse po flasim për paratë e qytetarëve? Pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, në shkollën 'Mihail Grameno', ka mungesë të mësimdhënësve të Gjuhës angleze dhe Matematikës, tani e një muaj, në kopshtin e ri që është hapur ka qëndrim vetëm dy orë, besoj qe duhet të rregullohet kjo çështje. Për punëtorët teknik ka shumë ankesa, a janë ekzekutuar pagat për muajt e tyre dhe kalimi i tyre në Ndërmarrjen Publike Lokale 'Fushë-Kosova Sh.A', a është i lejuar ligjërisht dhe a mund t'i fitojnë këto raste në gjykata? Subvencionimi i transportit për fëmijë është mirë të parashihet buxhet shtesë për këtë kategori. Pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, sa më parë të bëhet projekti dhe të fillojë rregullimi i kanalizimit në objektet afër gjykatës, e di që keni invenuar dhe ju falenderoj por problemi është i madh dhe duhet projekt konkret, po ashtu në disa rrugë duhet të intervenohet për ndriçim publik. Për Drejtorin e Drejtorisë së

Infrastrukturës, të shikohet mundësia të intervohet në rrugën përgjatë Hekurudhës, e cila është e asfaltuar dhe lidhet me nënkalimin e fshatit Lismir, ose të krijohet rrugë njëkahore, sepse po krijon problem, por nëse mund të zgjerohet është mundësi shumë e mire, sepse ka qarkullim të madh të automjeteve. Është mirë të bëhet edhe shenjëzimi i rrugëve, sepse po fillon sezona vjeshtë-dimër dhe krijohen probleme për shofer, njëra nga rrugët që ka nevojë për shenjëzim është rruga e Sllatinës në drejtim të Grabocit, po edhe në fshatra tjera. Pyetje për Kryetarin e Komunës, në cilen fazë është objekti i Zjarrfikësve? Për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, e kam edhe një pyetje, mundësia për krijimin e një linje të autobusëve Fushë-Kosovë / Parku i Pishave të Sllatinës së Vogël, sepse nuk kanë mundësi të gjithë, të kalojnë andej me automjete private.

Aida Alimi: Përshëndetje tani për ju, kryetar, kryesues, kolegë, drejtor dhe ju të pranishëm, ende nuk janë funksional mikrofonët, nuk kemi ID karta, nuk kemi letra identifikuese para vetës, nuk po mundeni Kryesues i Kuvendit të Komunës të funksionalizon gjërat elementare. Transmetimi live i mbledhjeve ka qenë premtimi i yti personal, i nderuari kryesues dhe kam shpresuar se do ta mbani. Një pyetje për Komisionin për emërimin e rrugëve, deri ku ka mbërritur puna e atij komisioni? Po ashtu për qenët endacak në Fushë-Kosovë, është problem permanent dhe është mirë të bëhet një zgjidhje sa më parë. Në shume lokale në Fushë-Kosovë, po ndodhin dukuri negative andaj e lus Inspektoriatin që të marrë masa. Për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, si do të mbulohen orët e humbura në Gjimnazin 'Hivzi Sylejmani', pasi që një muaj nuk ka mësimdhënës të Gjuhes Shqipe dhe Gjeografisë.

Dardane Sogojeva Shala: Përshëndetje, kryetar, kryesues, kolegë dhe ju të pranishem. Pyetje për Drejtoreshën e Zhvillimit Ekonomik, bizneset 'Start-Up', që janë përfitues në vlerë 3,000.00€ - 4,000.00€, a keni formuar komision për të dalur në terren, të shikojnë a jnë aktive këto biznese që kanë përfituar dhe pse në listën preliminare janë 40 biznese, ndërsa në listën përfituese përfundimtare janë 44? Pyetje për Drejtoreshën e Administratës, sa punëtorë i keni që vijnë në mëngjes në punë dhe marrin pagë dhe sa i keni që nuk vijnë në punë, duke përfshirë punëtorët me projekte dhe parking i komunës pse disa punëtorë, kanë të drejtë të hyjnë brenda me automjete dhe pse disa nuk kanë të drejtë? Kryetar i Komunës, çdo vikend udhëtime zyrtare, pse është e nevojshme të vijnë 4 - 5 persona nga stafi juaj dhe a është e vërtetë, që një ndërtues ka marrë leje ndërtimi dhe i keni kërkuar një banesë, kinse për raste sociale, nëse po është mirë të na tregoni, e nëse jo nuk është e vërtetë, unë në mbledhjen tjetër e jap emrin dhe mbiemrin e ndërtuesit. Pyetje tjetër për Kryetarin e Komunës dhe për Drejtorin e Drejtorisë së Pronës, mos jeni ngutur pak që e keni shkarkuar, pasi që ka kënduar në polici dhe po i dike mirë punët e komunës.

Ermal Dumani: Përshëndetje për të gjithë, i kam bërë disa kërkesa te Kryetari i Komunës, ku 3 kërkesa kryesore nuk më janë plotësuar të fshatit tim, kërkesa e parë është: Parku para shkollës së fshatit Miradi e Poshtme, e cila nuk është futur në buxhet, kërkesa tjetër është për asfaltimin e rrugës së Miradisë afër familjes Prekopuca, e cila është shtruar me zhavor dhe e falenderoj Drejtorin e Infrastrukturës z. Arianit Tërmkolli, ajo rrugë i lidhë dy fshatrat Miradi e Epërme - Miradi e Poshtme dhe nuk është futur në buxhet. Ajo që bjen në sy është ndërtimi i urave në fshatrat Miradi, Pomozotin dhe Vragoli në vlerë prej: 120,000.00€, unë kam dal në terren më Drejtorin z.

Arianitin, kam shikuar atë pjesë të urës që lidhet mes fshatrave dhe sipas analizimit nga drejtori, ajo pjesë kushton rreth 80,000.00€, sepse është pjesë e gjatë dhe tani nuk e di, si do munden të përfundojnë 3 urat me atë shumë të mjeteve financiare, duhet ta keni prioritet rregullimin e tyre, sepse lehtëson shumë biznese dhe neve si banorë, qarkullimin.

Ali Ismaili: I nderuar, kryetar, kryesues, kolegë, shumicën e pyetjeve i parashtroi kolegu z. Valon Murseli, kam dy pyetje njëra është çka po ndodhë me Ndërmarrjen Publike Lokale të Fushë Kosovës, ku drejtori i Ndërmarrjes Publike Lokale, po u kërkon bizneseve ta mbështesin me mjete pune ose me mjete financiare dhe nuk e di, a është në rregull kjo, sepse Kuvendi i Komunës po del në pozitë të keqë. Komunës së Fushë-Kosovës, gjithmonë i ka tepruar buxheti dhe është mirë të ndahet buxhet shtesë për Ndërmarrjen Publike Lokale, e mos të kërkohen mjete pune dhe financiare nga bizneset. Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban, të gjitha lejet i ka lëshuar me bonuse, në një vendim që e kemi marrë për bonuse është shfuqizuar, pse lejet po i lëshoni me bonuse? A do të i'a jepni 'Al Trade' bonuset që të rifillojnë Xhamia dhe Çerdhja, atje ku ka qenë sepse punimet e Xhamisë i keni ndërprerë? E përgëzoj një asambleistë këtu, që ka punësuar vajzën.

Vjosa Kida Hyseni: Përshëndetje për të gjithë, kam një pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ku komisioni për subvencionet e sportistëve, prej kujt është i përbërë dhe si është bërë vlerësimi i sportistëve, sepse disa nuk kanë përfituar, e disa të tjerë po.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Meqenëse nuk ka të tjerë që dëshirojnë të marrin fjalën, e konstatojë që ka përfunduar koha e pyetjeve, vazhdojmë me përgjigjet nga Ekzekutivi i Komunës.

Kryetari i Komunës: Përshëndetje për të gjithë, z. Migjen Kolshi baneri përballë komunës ka defekt, kemi biseduar më organizatorët që ta rregullojnë, dy ditë më herët e kemi vendosur te rrethi me një operator privat 'Orën e Pritjes'. Shkarkimi i Drejtorit të Pronës, unë kam paralajmëruar që nëse drejtorave të mi, ju fillojnë hetimet dhe ju pamundësohet ardhja në punë, siç ka qenë rasti me Drejtorin e Pronës, për tu zbatuar hetime si duhet, unë e kam liruar nga detyra. Në stafin tim nuk mund të ketë drejtor që hetohen dhe akuzohen, hetimi nuk do të thotë fajësi, por për tu zhvilluar hetimet si duhet, e kemi liruar nga detyra dhe ai nuk ka pasur të drejtë të vijë në punë, arsyeja e vendimit të gjykatës. Tani ju z. Valon Murseli, i përmendet tri kërkesa që i keni bërë për auditim, e keni konsumuar numrin për auditime, zyrën e prokurimit do ta auditojmë komplet, çka ka ndodhë në vitin 2026. Tek nepotizmi për Ndërmarrjen Publike Lokale, nuk e di për çfarë e patët fjalën, ajo është institucion që është etnitet në veti dhe mundeni të ju drejtoheni direkt Ndërmarrjes dhe aksionarëve që janë të këtij kuvendi. Ka qenë premtim i imi gjatë fushatës, se përparësi në punësim do të kenë banorët e Komunës së Fushë-Kosovës dhe këtë premtim do ta mbajë. Te zjarrfikësit, tani Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, e ka dërguar kërkesën në Agjensinë për Menaxhimin e Emergjencave dhe pritet nga ta të vendosin, kur do të fillojë. Për linjën e autobusëve 'Fushë-Kosovë-Parku i Pishave', do ta shohim momentin kur të krijohet infrastruktura e nevojshme. Komisioni për emërtimin e rrugëve znj. Aida Alimi, edhe unë dua të shoh rezultat nga ai komision, sepse ka shumë kërkesa që vijnë edhe tek unë. I nderuari z. Ali Ismaili, po ndërtohet me bonuse, sepse është një e drejtë e fituar nga vendimet e kaluara, jam vendime që kanë qenë të aprovuara nga Ish-Drejtori i Planifikimit Urban dhe Ish-Kryetari i Komunës, lejet janë marrëveshje që kanë qenë valide, në marrëveshje të reja bonuse nuk ka, sepse ky Kuvend, e ka shfuqizuar

vendimin për bonuse. Sa i përket asaj që theksuat ju z. Ali, se Ndërmarrja Publike Lokale, po kërkon mjete financiare në biznese, unë nuk e di që Ndërmarrja kërkon mjete financiare nga bizneset, donacione kanë ofruar dhe nuk është turp, sepse janë biznese që operojnë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovë, sa i përket Xhamisë, po besoj që në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës, e cila është sot jepet aprovimi për procedura të mëtutjeshme që pronat e Agjensisë Kosovare të Privatizimit, të kalojnë në pronësi komunale. Dikush tha që Drejtori i Pronës, ka kënduar në polici, të këndon, vetëm të zbardhet e vërteta. Sa i përket banesës për raste sociale, jam i informuar për atë banesë, që e ka ofruar një ndërtues kur e ka kuptuar që bonuset i ka nga vendimet e kaluara, me vetë dëshirë e ka ofruar atë banesë, me sa e di unë, ende nuk ka përfunduar si procedurë, në momentin që kalon në pronësi komunale, një komision që do të formohet do ta zgjedhë përfituesin, pasi që ka shumë raste sociale në komunën tonë, kjo do të jetë publike. Në vikend nuk jam në udhëtime zyrtare asnjëherë, pyetja pse janë shtuar 4 biznese në listën e përfituesve në 'Start-Up' biznese, ata i ka shtuar komisioni, sepse ka qenë afati i ankesave dhe e kanë parë që kanë të drejtë, pastaj janë shtuar, ka qenë kusht që në momentin që shpallen përfituesit mandej me pas biznesin e regjistruar në ARBK. Tani ju z. Migjen Kolshi, të gjithë mund të dërgojnë kërkesë për hetim, nuk jap dorëheqje nëse fillojnë hetimet.

Pika e pestë (5) - Propozim për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029 dhe Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2027.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029 dhe Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2027', ftoj Drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave që të na paraqesë këtë propozim në mënyrë më të detajizuar para Kuvendit të Komunës.

Drejtori për Buxhet dhe Financa: Përshendetje për të gjithë, unë do mundohem ta elaboroj planifikim e buxhetit nga fillimi i vitit deri më sot. Planifikimi i buxhetit ka filluar, me fillimin e vitit fiskal dhe është hartuar në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048, po ashtu dhe Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040. Pas vlerësimeve të herëshme që në muajin Shkurt, i kemi dërguar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, në muajin Maj, e kemi pranuar Qarkoren e parë buxhetore Nr. 01/2027. Me pranimin e kësaj Qarkore Buxhetore, ne kemi hartuar Qarkoren e Brendshme Buxhetore, që i kemi shpërndarë nëpër programe dhe nën-programe, i kemi dërguar te Shefat e Sektorëve, ata kanë pasur afate dy javë që të plotësohet dhe të kthehet te zyra e planifikimit të buxhetit, pasi kemi marrur Qarkoren, kemi filluar procedurat për hartimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore, e cila është aprovuar nga ky Kuvend në muajin Qershor. Në muajt Korrik dhe Gusht, i kemi pasur disa dëgjime publike me qytetarë të ndryshëm nëpër vendbanime, pastaj në muajt Gusht-Shtator kemi filluar me realizimin dhe planifikimin e buxhetit në 'Sistemin e BDMS-së' dhe të programeve Investime Kapitale. Buxheti i Komunës për këtë vit është: 29,389,877.00€, kemi rritje prej 9.65%, rritja ka ndodhur te granti i përgjithshëm prej: 1,193,927.00€, ose 9.47%, te granti i arsimit me 580,000.00€, ose 8.04%, te granti i shëndetësisë me 300,000.00€, ose 11.76% dhe të hyrat vetjake janë rritur 510,000.00€, ose 11.55%, do të thotë totali i rritjes në vlera monetare është

2,586,291.00€. Totali i granteve qeveritare është: 24,455,196.00€, ose 83.21%, ndërsa të hyrat vetjake për vitin e ardhshëm janë 4,934,618.00€, ose 16.79%. Struktura e shpenzimeve nëpër kategori ekonomike për vitin 2027, është kjo: Paga dhe Mëditje i kemi 11,504,375.00€, ose 39.15%, e buxhetit. Kemi rritje të stafit prej 110 normave, në arsim 76, në shëndetësi 34, do të thotë totali është 1234 vende pune për vitin e ardhshëm. Te investime kapitale, i kemi gjithsej 83 projekte, 14 projekte janë në vazhdimësi, totali i Investimeve Kapitale është 11,413,604.00€, financohen prej dy burimeve: granti i përgjithshëm dhe të hyra vetjake. Granti i përgjithshëm financon 78%, ndërsa të hyrat vetjake janë 22%. Shuma më e madhe e këtyre projekteve është e koncentruar në 4 drejtori: Infrastrukturë, Arsim, Shërbimeve Publike dhe Shëndetësisë, në përqindje i bjen: 34.47% janë në Infrastrukturë, 20% janë në Arsim, 18% janë në Shërbime Publike dhe 8% janë Shëndetësi. Projektet që marrin më së shumti buxhet janë: Asfaltimi në Qytet dhe Fshatra prej: 2,629,483.00€, ose 23%, Ndërtimi dhe Rregullimi i Trotuareve në shumë prej: 830,000.00€, ose 8.7%, Ndërtimi i Parqeve në shumë prej: 300,000.00€, ose 2.63%, Blerja e Automjeteve në shumë prej: 710,000.00€, ose 6.23% dhe Ndërtimi i Kanalizimeve ose Ujësjellësve në shumë prej: 450,000.00€, ose 3.94%. Njëra nga projektet shumë vjeçare është 'Ndërtimi kampusit të shkollave të mesme', fillon në vitin 2027-2028-2029 dhe ka vlerë diku rreth 5,000,000.00€, pastaj e kemi palestrën sportive, pompat termike dhe kështu me radhë. Ne si komunë renditemi në vendin e shtatë, sa i përket inkasimit të të hyrave vetjake, kemi 4, 934,681.00€, tatimi në pronë është 1,227,000.00€, pastaj lejet për ndërtesa 1,520,000.00€ dhe në fund e kemi tabelën për buxhetimin gjinor, e cila është shpërndarë për të gjitha kategoritë: subvencione, paga, mallëra e tjera.

Kosovar Ademi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, falenderojmë Ekzekutivin e Komunës, që e ka hartuar Kornizën Afatmesme Buxhetore, duke u bazuar në nevojat e qytetarëve, projektet janë orientuar në fushat ku nevojat janë më të mëdha. Natyrisht kërkesat janë të mëdha por besoj, se gradualisht do të shqyrtohen dhe të përfshihen në vitet e ardhshme, ne e mbështesim këtë Kornizë buxhetore dhe planifikimin e buxhetit për vitin 2027 dhe besojmë se është një hap i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejmë të Komunës së Fushë-Kosovës.

Laureat Gojnovci: Sot po e diskutojmë dokumentin më të rëndësishëm të komunës për një vit dhe Kryetari i Komunës, nuk gjeti kohë të rrijë këtu dhe të diskutojmë, do doja ta ballafaqoja me premtimet e tij, të cilat nuk i ka inkorporuar në buxhet, nuk po e shohim as Nënkryetarin e Komunës dhe nuk e di, sa do mundemi të bëjmë një diskutim të mirëfilltë, mirëpo fatëmirësisht po incizohemi dhe do ta jap qëndrimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës sa i përket buxhetit. Sot jemi duke votuar një dokumentë që ju shërben qytetarëve të Komunës së Fushë-Kosovës dhe jo një listë të projekteve të cilat do të mbesin në letër, ky buxhet nuk do të përkrahet nga Lidhja Demokratike e Kosovës në Fushë-Kosovë. Janë disa arsye: vlera e projekteve janë të ulëta dhe jo reale, po shohim projekte në vlerë 10,000.00€ ose 20,000.00€, këto vlera nuk janë të mjaftueshme për realizmin e atyre projekteve, pra kemi një buxhet që në vete prodhon projekte të parealizueshme, së dyti buxheti është i fragmetuar dhe pa ndikim real, në vend që të kemi projekte të mëdha kemi një shpërndarje në projekte të vogla, siç e tha edhe drejtori shumica janë asfaltime. Shumica e premtimeve të Kryetarit të Komunës nuk janë inkorporuar në këtë buxhet, ka premtuar

ndërtimin e një shkolle fillore në qytet, e cila nuk është në buxhet, ndërtimin e një 'Kampusi modern për shkollat e mesme në Nakaradë', drejtori tha ka një kosto financiare prej: 5,000,000.00€, për vitin 2027, janë ndarë 50,000.00€ për atë projekt, nëse në vitin 2028 i keni 500,000.00€, e për vitin 2029, janë 5,000,000.00€, atëherë është shpërndarje jo e balancuar mes viteve. Në zhvillim ekonomik keni premtuar grante të vogla 1,000.00€ deri 3,000.00€, ndërsa këtë vitë kanë marrë deri 4,000.00€, njerëz të afërm të Lëvizjes Vetëvendosje, në këtë drejtori keni futur projekte që nuk janë farë në kuadër të kësaj drejtorie siç është: rregullimi i objekteve banesore, tabela informuese në qytet dhe fshatra. Te infrastruktura publike, a keni paraparë premtimin e Kryetarit të Komunës për futjen e kabllove të rrymës dhe telefonike nën tokë në zonat urbane? Ndërtimi i sheshit të qytetit në rrugën 'Nëna Terezë' janë ndarë 100,000.00€, nga rrethi deri te Stacioni Hekurudhor, nuk besoj se mjaftojnë ato mjete financiare. Instalimi i stacioneve të reja të pompimit të ujit dhe rezervuarëve nuk është askund, prapë mbetet vetëm premtim. Kryetari i Komunës ka thënë gjithashtu, se do ta bëjmë kogjenerimin e qytetit të Fushë- Kosovës, asnjë cent nuk e ka paraparë për kogjenerim, e as studim fizibiliteti. Ku janë parkingjet me kate, ku është unaza që e lidh qytetin e Fushë-Kosovës, me auto-stradë, ku janë autobusët ekologjik, ndërtimi i stacionit të autobusëve, në kulturë e kani hapur një kod: Renovimi apo ndërtimi i shtëpisë së kulturës, as vetë nuk e dini, a do ta renovoni apo do ta ndërtoni, çka me varrezat e qytetit dhe të fshatit Miradi e Epërme, e keni hapur një kod me emërim: ndërtimi i varrezve në qytetin e Fushë-Kosovës, me vlerë 100,000.00€, çka do të ndërtoni në varreza, nuk ka prona në qytet, nuk keni paraparë blerje të pronave në qytet ose në Miradi të Epërme. Ku është 'Qendra Rinore', e premtuar nga Kryetari i Komunës, në sport doni të renovoni stadiumet në Miradi të Epërme dhe Sllatinë të Madhe, me nga 50,000.00€, me atë shumë nuk do të mundeni të rregulloni, as rrethojat e atyre stadiumeve. Mungojnë projektet e nevojshme për qytetin, parkingjet shumëkatëshe, investime serioze në shkolla e çerdhe, zgjidhje konkrete për trafikun urban, transport publik dhe funksional brenda qytetit, parqe të mëdha dhe hapësira modern rekreative, nuk ka projekte për kanalizim dhe infrastrukturë bazike, këto janë nevoja reale të qytetarëve dhe mungesa e tyre është dështim planifikimi. Ka pa qartësi serioze në projekte konkrete, keni ndarë mjete financiare pa pasur hapësirë ku me ndërtuar, salla e sportit në rrugën 'Aziz Zhilivoda' nuk ka teori të ndërtohet aty, kjo tregon mungesë të planifikimit real me gjendjen faktike në terren, disa projekte duket se janë futur në buxhet vetëm për ta plotësuar listën, ky buxhet nuk tregon se ka do të shkojë Fushë-Kosova, nuk ka projekte transformuese, nuk ka projekte të qarta dhe nuk ka guxim për vendime të mëdha, ne nuk do ta votojmë këtë buxhet, sepse nuk i përmbush premtimet e subjektit fitues në Komunën e Fushë-Kosovës, nuk ju shërben qytetarëve, nuk janë mbajtur dëgjimet publike në çdo fshat, ka shumë arsye, pse ky buxhet duhet të kthehet në rishqyrtim.

Migjen Kolshi: Ky buxhet duhet të jetë një pasqyrë e qartë e prioriteteve dhe premtimeve që kjo qeverisje ju ka dhënë qytetarëve të komunës tonë, për arsye se është buxheti i parë i kësaj qeverisje i sjellë në Kuvend, une do të doja që Kryetari i Komunës të ishte prezentë dhe të ballafaqohemi me premtimet të cilat i ka dhënë. Nuk është bërë akoma një vitë, që nga fushata zgjedhore dhe Kryetari i Komunës ka dhënë premtime të mëdha, ka qenë arsyeja pse i ka fituar zgjedhjet e nivelit të komunës, në këtë buxhet nuk janë përfshirë shumica e projekteve që janë shumë të rëndësishme

për qytetarët e Fushë-Kosovës, duke filluar nga shkolla dhe kopshti në lagjen 'Eliza C', stacioni i autobusëve, ngrohja e qytetit, kabllot nën sipërfaqen e tokës, sheshi i qyetit, zgjerimi i rrugës Uglar-Bresje, zgjerimi i rrugës M9, ndërtimi i rrugës nga stacioni i trenit deri te pompa Hib Petrol, transporti falas për nxënës dhe student e tjera. Një numër i madh i projekteve të përfshira në buxhet nuk realizohen, njëra ndër to është ndërtimi i çerdhes në lagjen 028 dhe 029, nuk ka pronë për tu ndërtuar ajo çerdhe, po ashtu nuk mund të ndërtohet fusha e sportit në lagjen 028 dhe 029, e njëjta vlen edhe për stadiumin në Sllatinë të Madhe. Në këtë buxhet janë ndarë 350,000.00€ për zhavor, nuk mendoj se kemi mundësi të ndajmë, aq shumë mjete financiare për zhavor drejtor dhe kjo do të jetë mundësia, që të keqëpërdoren. Mjetet financiare për renovimin e shkollave i keni rritur por i keni shtyer për një vitë. Riparimi i rrugëve të asfaltuara nëpër vendbanime dhe fshatra ishin të ndara 500,000.00€, çka do të thotë kjo drejtor? Pasi që vijë nga fshati Harilaç, i kemi disa kërkesa të deponuara në arkiv me mbi 100 nënshkrime njëra ndër to është rruga 'Atava' dhe nuk është përfshirë në buxhet, në këtë buxhet fshati Harilaç është i diskriminuar sa i përket projekteve publike. Në këtë projekt-buxhet është përfshirë rruga 'Lisi i Progonit', për degëzime, ajo rrugë nuk ka nevoje për degëzime fare. I vetmi fshat i cili nuk ka fushë futbolli është fshati Harilaç dhe nuk është paraparë në këtë buxhet, cila është arsyeja, është kërkesë e imja tani e shumë vite, nuk janë paraparë parkingjet e shkollës për fshatin Harilaç, është problem që ju shkakton vështirësi prindërve për t'i marrë fëmijët nga shkolla. Ndërtimi i nënkalimit në rrugën 'Pajazit Islami', me 90,000.00€, nuk besoj që mund të ndërtohet një nënkalim dhe ku është paraparë kjo, a ka hapësirë? Shuma prej: 100,000.00€ është ndarë për ndërtim të parkingut te kisha, a ka hapësirë aty, shumica e projekteve janë për fshatin Bardh i Madh, andaj mbështetur në strukturimin e këtij buxheti në mënyrë jo të drejtë, ne si Parti Demokratike e Kosovës, nuk e përkrahim për aprovim këtë buxhet.

Dashnim Bajrami: Përshëndetje Kryesues i Kuvendit të Komunës dhe ju të pranishëm, sot si pjesë e këtij Kuvendi po shqyrtojmë një buxhet që fuqizon bashkëpunimin e komunës me komunitete, ky planifikim dëshmon se kur institucioni punon me ndershmëri dhe zhvillimi prek secilën lagje, ky projekt-buxhet sjellë investime kapitale të ndara, specifike dhe të qarta që prekin direkt zonat tona. Arsimi parashkollor, çerdhja e re e fëmijëve në lagjen 028 dhe 029, është ndarë prona për ndërtimin e saj, gjithashtu edhe për sallën e sportit. Transporti rrugor kemi bërë kërkesë dhe ka hyrë në buxhet, gjithashtu edhe asfaltimi i rrugëve tona si: Pashko Vasa, Gjeravica, Molla e Kuqe, Gaula Rosi e tjera. Ndërtimi i pallateve të reja në lagjen tonë, ndërtimi i trotuarëve që garanton siguri për këmbësorët tanë, kjo tregon përfaqësimin tonë ndaj komuniteteve dhe unë do ta votojë këtë buxhet, sepse në të planifikuara interesat e komunitetit tone.

Suhat Ademi: Të nderuar kolegë asambleistë dhe ju të pranishëm, më lejoni t'i tregojë arsyet e mia të mos votimit të këtij buxheti, propozimi 2027-2029. Me datë 30.06.2026, nuk e kam votuar këtë buxhet, sepse në këtë buxhet nuk është paraparë asnjë investim në fushën e infrastrukturës në lagjet e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian dhe kam ngritur shqetësimet e mia, për mospërfshirjen e lagjeve të komuniteteve. Arsyeja që do ta votojë sot këtë buxhet, është që infrastruktura publike është paraparë, asfaltimet në lagjet 028 dhe 029, si rrugët: Pashko Vasa, Gjeravica, Molla e Kuqe, Gaula Rosi e tjera, ku këto asfaltime nuk kanë qenë të përfshira në buxhetin e kaluar në kornizë. Arsyeja tjetër është ndërtimi i kanalizimeve në lagjen 028 dhe 029,

ndërtimi i sallës së sportit në lagjen 028 dhe 029, ndërtimi i çerdhes në lagjen 028 dhe 029, këto janë arsyet, pse unë do ta votojë buxhetin për vitin 2027.

Ali Ismaili: Sot kemi një nga pikat më të rëndësishme të vitit dhe nuk e kemi prezentë Kryetarin e Komunës, Nënkryetarin e Komunës dhe as pjesën më të madhe të Ekzekutivit të Komunës, nuk e kanë marrë mundin fare me qenë këtu, kjo tregon sa i rëndësishëm është qytetari për ta pasi që e kanë marrë pushtetin. Buxheti është i madh, po fokusohem më shumë tek Investimet Kapitale, shifrën e kemi diku 11,413,304.00€, po ashtu te të hyrat vetjake dhe grante kemi rritje prej: 46.95%, granti i arsimit prej: 26.55%, të hyrat vetjake prej: 16.79%, ndërsa granti i shëndetësisë prej: 9.72%, mendoj që shëndetësinë e kemi shumë keq. Kur e lexojmë strukturën e Investimeve Kapitale, shohim një zhgënjim të madh, me shifra që janë fryer, projekte fantazmë dhe ekziston një pabarazi mes qytetit dhe fshatrave, andaj mbi bazën e kujt, e keni ndarë këtë buxhet, a keni pasur ndonjë kriter, sepse fshatrat janë lënë si dorë e dytë dhe mendoj që janë të barabartë. Te Investimet Kapitale në Infrastrukturë, është buxheti 'Copy-paste' nga vitet e kaluara, sepse keni paraparë 3,934,483.00€, pa transparencë fare, pa projekte. Keni paraparë drejtor 350,000.00€ për rrugë bujqësore dhe kanale kulluese, 500,000.00€, për rehabilitmin e rrugëve të asfaltuara, 400,000.00€, për rrjetë ujësjellësi në fshatrat Vragoli dhe Miradi e Poshtme, këtu nuk specifikohet asgjë, sa prej premtimeve i keni futur këtu, sa metra kanalizim do të shtrohen në fshatra, sa familje përfitojnë? Mendoj që janë projekte të ricikluara nga viti në vitë dhe të mbushura, sa për sy e faqe për qytetarin. Granti në shëndetësi u pa që është i ulët, shuma prej: 210,000.00€, keni paraparë automjete, çfarë automjete do të blehen? Shuma prej: 187,623.00€ për blerjen e paisjeve mjekësore, çfarë paisje mjekësore? Shuma prej: 530,000.00€, për katin shtesë në Qendrën e Mjekësisë Familjare 1, ne nuk e kemi të qartë kur fillojnë këto procedura dhe kur mbarojnë? A kemi ndonjë kontrollë në këtë që e keni paraqitur ju në buxhet, shërbimet elementare qytetarët nuk i kanë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare. Te investimet kapitale në arsim, po mbesin vetëm në letër, shuma prej: 1,047,000.00€, për pompa termike në shkolla, shuma prej: 350,000.00€ për renovimin e objekteve shkollore, shuma prej: 300,000.00€ për pajisje smart, shuma prej: 250,000.00€ ndërtimi i shkollës në Lismir, shuma prej: 200,000.00€ për lagjen 028 dhe 029, pastaj për çerdhe, të gjitha këto projekte nuk na i keni paraqitur si duhet, mendoj që keni ardhur vetëm me shifra dhe nuk jeni korrekt në raport me qytetarët. Sporti, shuma prej: 330,000.00€ salla sportive, ku janë këto projekte kapitale? Afatet e sakta të zbatimit të investimeve nuk janë, cilat parqe do të bëhen në qytet me gjysëm milioni euro, pra nuk i kemi lokacionet. Si mund ta arsyetoni faktin që shpenzimet e rregullta të mirëmbajtjes, vazhdojnë të futen te investimet kapitale, ky është manipulim i strukturës së buxhetit. Buxheti e sidomos investimet kapitale, nuk duhet të jetë katalog dëshirash, kërkojë llogari të plotë për preventivën, lokacionin, sasinë e punimeve, afatin dhe kriteret reale dhe jo premtime, që në teren nuk kanë fare efekt, për këto arsye, unë nuk do ta mbështesë këtë buxhet.

Rrahim Tërnava: Përshëndetje për të gjithë, kam një pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, shuma prej: 400,000.00€, janë ndarë për blerjen e paisjeve smart dhe nuk po e shoh që keni saktësuar çfarë do të blihet, jemi foksuar vetëm në ndërtime por jo në kërkesa, se çfarë po kërkon tregu i punës sot, do të ishte mirë të definohet saktë buxheti, a do të trajnohen mësimdhënësit

sidomos të informatikës, që ata t'i trajnojnë nxënësit për tregun e punës dhe buxheti, të ndahet edhe për programe të ndryshme për intelegjencë artificiale. Të fokusohemi më shumë në mësimdhënie që nxënësit të dalin më të përgatitur.

Ali Topalli: Përshëndetje për të gjithë ju të pranishëm, kryesues me përfundimin e pikës: Pyetje dhe përgjigje parlamentare, e kuptova se sa serioze është kjo pikë e planifikimit buxhetor, u largua një pjesë e anëtarëve të Kuvendit, duke ju përfshirë kohë pas kohe edhe juve, prandaj po bindem se kjo pikë nuk paraqet seriozitet, sigurisht edhe planifikimi është bërë kështu. A ka Zëvendës Kryesues Kuvendi, apo jo? Sa i përket planifikimit të buxhetit, dua të ndalem te pjesa e kulturës, rinisë dhe sportit, fillimisht do të doja që pjesë e këtij buxheti të ishin gërmimet arkeologjike në fshatrat Bardhi i Madh dhe Harilaç, kalaja e Harilaçit ka sipërfaqe prej 1.4 hektarë dhe gërmimet atje kanë filluar në vitin 2005, ato janë bërë me buxhetin e komunës dhe pjesërisht me buxhetin e Ministrisë së Kulturës, ndërsa punimet i ka kryer Instituti Arkeologjik dhe Muzeu i Kosovës. Kjo kala i takon shekullit IV dhe VI, është ndërtuar në dy faza. Kalaja e Bardhit të Madh është jashtëzakonisht e rëndësishme, sepse aty është zbuluar një varrezë, e cila për herë të parë u evidentua gjatë njohjes së vitit 2004, për njohje e cila është bërë me qëllim të krijimit të Hartës Arkeologjike të Kosovës, e po në këtë vitë u gërmuan tre sondazhe, në të cilat u zbuluan dymbëdhjetë varre, gërmimet atje ishin përqëndruar në lindje dhe juglindje të sondës 1 në vitin 2004, pastaj u punua në dy sektore A dhe B. Në sektorin A janë hapur 40m2, pastaj me qëllim të për caktimit të kufijëve lindor në Bardh të Madh, të shtrirjes së varrezave janë hapur edhe 5m2 tjera, do të thotë që sektori i varrezve është zgjeruar, ndërsa sipërfaqja e kësaj hapësire është 213m2, këto informata ju dhashë në mënyrë që të planifikoni mjete financiare për gërmime arkeologjike. Në subvencionet e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, vërejta se për vitin 2027, janë planifikujar shuma prej: 130,000.00€, kulturë dhe rini, kurse po ashtu shuma prej: 130,000€, për sport dhe rekreacion, pra në total 260,000€, përgjysëm më pak se këtë vitë, duke e llogaritur numrin e banorëve në komunën tonë, gjithashtu dhe numrin e sportistëve i bjen që për kokë sportisti të ndahen 9.91€ në vitë, kurse për kokë të numrit të rinjëve i bjen 3.15€, kjo është e pjesëtuar më 12,000, të rinjë që përfshihen në sport, rini dhe rekreacion, shifrat i keni tek Agjensia e Statistikave të Kosovës. Palestra e Sportit në rrugën 'Aziz Zhilivoda' në vlerë prej: 100,000.00€, më intereson ta dijë, a bëhet fjalë për palestër apo sallë, nëse është palestër, a mund të na tregoni pronën, ku do të bëhet kjo? Shtëpia e Kulturës në fshatin Sllatinë e Madhe, ajo pronë është e KBI-së, a do të investoni aty apo jo, është çështje e juaja. Ndërtimi i sallave të sportit në Fushë-Kosovë dhe në lagjet 028 dhe 029, në cilin vend në Fushë-Kosovë do të ndërtohen? Ndërtimi ose renovimi i Shtëpisë së Kulturës në Fushë-Kosovë, ajo shtëpi është në gjendje të mjerueshme por në mbledhjen e muajit Maj të këtij viti, drejtori i Kulturës në këtë foltore ka thënë se 'Për dy javë e nënshkruaj memorandumin prej 2,000,000.00€', ndërsa në buxhet figurojnë vetëm 50,000.00€ dhe nuk dihet, a është ndërtim apo renovim, nuk ka të specifikuar asgjë.

Vjosa Kida Hyseni: Me rritjen e buxhetit këtë vitë të ndahen vetëm 200,000.00€, në sektorin e bujqësisë, mendoj që është shumë pak, është një zhgënjim i madh për fermerët e Komunës së Fushë-Kosovës, sepse nuk ka ndryshuar asgjë me rritjen popullsisë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Meqenëse nuk ka të tjerë që dëshirojnë të marrin fjalën, po e qesim në votim 'Propozimin për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029 dhe Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2027'.
U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', tetë vota 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej njëzet e gjashtë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje, gjithsej tridhjetë anëtarë.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se u aprovua 'Propozimi për Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029 dhe Buxheti i Planifikuar i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2027' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2027, në shumë të përgjithshme prej: 29,389,877.00€, i shpërndarë nëpër programe e nën-programe të kategorive ekonomike si vijon:

1.1 Për paga dhe shtesa për 1234 të punësuar në Administratën Komunale, Arsim dhe Shëndetësi, buxheti i komunës është në shumë prej: 11,504,375.00€;
1.2 Për mallra dhe shërbime, buxheti i komunës është në shumë prej: 3,500,000.00€;
1.3 Për shpenzime komunali, buxheti i komunës është në shumë prej: 550,000.00€;
1.4 Për subvencione dhe transfere, buxheti i komunës është në shumë prej: 2,422,198.00€ dhe
1.5 Për shpenzime në projekte kapitale, buxheti i komunës është në shumë prej: 11,413,304.00€.

2. Vlerësimet e hershme të cekura me kufijtë për buxhetin e planifikuar me Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin fiskal 2028 është në shumë të përgjithshme prej: 30,933,678.00€ dhe për vitin fiskal 2029 është në shumë të përgjithshme prej: 32,985,875.00€.

Pika e gjashtë (6) - Propozim për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 67, të datës 24.02.2026.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 67, të datës 24.02.2026, është vetëm plotësim, ku vendimit të datës 24.02.2027, i shtohet fjala 'Për të rriturit' me 'Sindromin doën dhe autizëm' dhe zbatimi fillon nga viti 2027, po e hapim diskutimin.
Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim për aprovim 'Propozimin për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 67, të datës 24.02.2026, ku i shtohet fjala 'Për të rriturit' me 'Sindromin doën dhe autizëm'.
Laureat Gojnovci: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përkrahim për aprovim 'Propozimin për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 67, të datës 24.02.2026, të cilit i shtohet fjala 'Për të rriturit' me 'Sindromin doën dhe autizëm'.
Valon Murseli: Mendoj që është diskriminim që përfituesit e ndihmës, duhet të jenë banorë të Fushë-Kosovës tri vitet e fundit dhe për këtë, kam dërguar shkresë tek Avokati i Popullit dhe besoj që do të marrë përgjigje pozitive dhe do të ndryshohet, ky fakt në thirrjen që ka qenë për bursa.
Ali Ismaili: Pse drejtorët që po i sjellin këto pika nuk janë prezentë të na elaborojnë pikën e tyre, është mirë Kryesues i Kuvendit të Komunës, që të kërkohet përgjegjësi, shpresoj që në të ardhmen të mbështeten edhe kategori tjera, unë e mbështesë këtë propozim.

Driton Ademi: Drejtoresha e Shëndetësisë është dashur të vijë dhe ta trajtoj propozimin, nëse themi se është ndihmë sociale, ne e dimë që skema e ndihmes sociale është e deleguar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale më herët e cila i përpunon këto raste në Qendrën për Punë Sociale, nëse themi që është skemë e pensioneve, unë e di që këta persona janë të përfshirë në skemën e personave me aftësi të kufizuar, që do të thotë ne marrim sot vendim, mirëpo ky vendim vlenë vetëm për këtë vitë fiskal, prandaj mendoj që Drejtoria e Shëndetësisë po bjen ndesh me Ligjin për Skema Sociale, Ligjin për Skema Pensionale të Kosovës dhe duhet të shikohet mirë pjesa e subvencioneve në Rregulloren e re të cilën e kemi aprovuar, ne po i japim mbështetje por Drejtoresha e Shëndetësisë është dashur të vjen të na elaboroj pak më mirë këtë pikë të rendit të ditës.

Dardane Sogojeva Shala: Kam kërkesë nga banorët dhe familjarët që kanë fëmijë me epilepsi dhe kërkojmë që edhe kjo kategori të përfshihet në ndihmë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kuptoj por është planifikim i tillë i Drejtorisë së Shëndetësisë, për kategori tjera bëjmë kërkesë dhe marrim inciantiva tjera, po e qesim në votim 'Propozimin për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 67, të datës 24.02.2026'.

U votua unanimisht nga anëtarët e pranishëm në mbledhje, gjithsej tridhjetë anëtarë.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se u aprovua 'Propozimi për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 67, të datës 24.02.2026' dhe mori:

VENDIM

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 1922, të datës 18.09.2026, të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, me ndryshim-plotësimin e paragrafit një (1), të vendimit Nr. 67, të datës 24.02.2026, për lejimin e mjeteve financiare prej: 100.00€, nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve Nr. (200), programi Administrata e Shëndetësisë Nr. 73011, me plotësimin edhe 'Për personat e rritur me Autizëm dhe Sindromën Daën', banorë të Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Shpenzimi i mjeteve financiare nga paragrafi një (1) i këtij vendimi, do të realizohet sipas planit dinamik të shpenzimeve mujore / tremujore dhe vjetore të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, nga një qind euro për secilin muaj dhe shpërndarjen e tyre tek fëmijët dhe të rriturit me Autizëm dhe Sindromën Daën.

Pika e shtatë (7) - Propozim për rishqyrtimin e vendimit dhe ndryshim-plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ne e kemi sjellë në Kuvend për shqyrtim 'Propozmin për kolegu tonë z. Gjelbrim Halili, për ta plotësuar përbërjen e Komitetin për Politikë dhe Financa', mirëpo është kthyer nga Ministria në rishqyrtim për arsye të mosplotësimit të kuotës gjinore, ka kërkuar që të plotësohet më një anëtare nga gjinia femërore, propozimi i parë ka ardhur dhe është për znj. Arlinda Mekolli. Hap diskutimin.

Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim për aprovim 'Propozimin për ndryshim-plotësimin e vendimit për përbërjen e re të Komitetit për Politikë dhe Financa', me largimin e z. Gjelbrim Halili, për arsye të mosplotësimit të kuotës gjinore dhe plotësimin me një anëtare nga gjinia femërore, propozimi i parë ka ardhur dhe është për znj. Arlinda Mekolli.

Laureat Gojnovci: Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, vetë fakti që e keni sjellë ndyshimin e Komitetit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, e keni ditur që i keni votat dhe Arlinda Mekolli, pritet të kalon në përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa. Më vjen keq prej znj. Arlinda Mekolli, se ne duhet të marrin pastaj veprime politike dhe ligjore, ligji është shumë i qartë, nëse doni të përfshini të gjitha subjektet politike, ne si Grup Parlamentarë i Lidhjes Demokratike të Kosovës, kemi marrë vendim që mos ta dërgojmë në Gjykatë, mos të kërkojmë masë të përkohshme që të bllokohet puna e Komiteti për Politikë dhe Financa, e kemi pranuar në një formë edhe pse është dëmtuar Lidhja Demokratike e Kosovës në Fushë-Kosovë, por nëse nuk mund të përshihen të gjitha subjektet politike për arsye të kuotës gjinore është ligji i cili thotë: në bazë të përfaqësimit të subjekteve brenda Kuvendit të Komunës, unë dje në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, theksova që i kemi nëntë anëtarë sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kur kemi qenë ne në pushtet Lëvizja Vetëvendosje, me 6 anëtarë në Kuvendin e Komunës, i ka pasur 2 vende në Komitetin për Politikë dhe Financa, ndërsa ne tani i kemi 9 anëtarë në Kuvend dhe vetëm 1 përfaqësues në Komitetin për Politikë dhe Financa, për arsye se jemi kolegë, ju bëjë thirrje ta votoni propozmin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, sepse na takon, mos na detyroni të bllokojmë punën e Kuvendit të Komunës. Në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, e kam dërguar shkresën por ne e dimë si funksionon ajo, në Gjykatë kemi angazhuar avokat dhe ka thënë që brenda javës do të bëjë një 'Masë të përkohshme për Komitetin për Politikë dhe Financa' dhe do të bllokohet Kuvendi. Ju lutem në Komitetin për Politikë dhe Financa të na jepni atë që na takon, mos e përdorni arrogancën e numrave, sepse do të na dërgoni në një situate, ku do të bllokohet Kuvendi. Propozimi ynë për anëtare në Komitetin për Politikë dhe Financa është znj. Vjosa Kida Hyseni.

Migjen Kolshi: Kryesues i Kuvendit të Komunës, unë pajtohem plotësisht me diskutmin e z. Laureat Gojnovci, mendoj se anëtari që duhet të hyjë në Komitetin për Politikë dhe Financa, duhet të jetë nga Lidhja Demokratike e Kosovës, nuk është ligjore që Lëvizja Vetëvendosje të ketë 4 anëtarë në Komitetin për Politikë dhe Financa, kërkojmë nga ju të respektoni ligjin si duhet. Sa i përket dërgimit në Gjykatë z. Laureat Gojnovci, ne si Grup Parlamentarë i Partisë Demokratike të Kosovës, të përkrahim, sepse po shkelet çdo barazi në këtë Kuvend.

Ali Ismaili: Zgjidhja e kësaj çështje është kuota gjinore, unë po tërhiqem nga Komiteti për Politikë dhe Financa, po kaloj në Komitetin për Komunitete, le të vjen një përfaqësuese femër nga cili do subjekt politikë, ka mundësi të rregullohet kjo çështje vetëm duhet mirëkuptim, sepse po flasim për trupat e Kuvendit. Kryesues i Kuvendit të Komunës për pjesën e parë keni vepruar drejtë, e keni bërë një gjithpërfshirje, kjo nuk do të thotë që herave të kaluara nuk kemi pasur, meqenëse dëshironi të bëjë zgjidhje është mirë, mirëpo Lëvizja Vetëvendosje të ketë 3 anëtarë në përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, e Lidhja Demokratike e Kosovës vetëm 1, mendoj që është padrejtësi. Zgjidhje ka mirëpo ju vendosi si do ta zgjidhni këtë punë.

Driton Ademi: Kjo nuk ndërlidhet me vitet e kaluara kur kam qenë unë në Asamblenë Komunale, sepse ka qenë tjetër Udhëzim Administrativ, në këtë Udhëzim Administrativ thuhet: Kuvendi merr vendim, ne kemi marrë vendim në lidhje me përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, ka shkuar në Ministrinë kompetente, pastaj Ministria nuk ka kontestuar asgjë, sikur ta kishte rikthyer

ndërsa komuna ta zbatonte, atëherë do të kishte të drejtë ta dërgonte në gjykatë, vendimet i kthen Ministria dhe i zbaton komuna ato shkojnë në gjykatë, ne nuk e kemi këtë rast, vendimi është marrë, Ministria kompetente nuk ka reaguar. Në Udhëzimin e ri administrative, është përqindja e përfaqësimit, në tjetrin nuk ka qenë, thotë: reflekton përbërjen e entiteteve politike, në këtë përbërjen sot qëndrojmë mire, sa i përket Komiteteve të Përherëshme, çka dua të ndërlidhë me situatën aktuale p.sh. gjatë zgjedhjeve votat që teprojnë të një subjekti, që nuk arrinë të kalojë pragun ju shpërndahen subjekteve politike, duke filluar nga subjekti më i madh deri te subjekti më i vogël, është rasti i njejtë në këtë situatë. Një gjë ta dimë se Ministria e ka kthyer vendimin vetëm për kuotë gjinore, këtu duhet të bëhet rregullimi, jo të kthehet në fillim, ky është qëndrimi im personal, aq sa kam mundur ta kuptojë Udhëzimin Administrativ.

Laureat Gojnovci: Tani z. Driton Ademi të dëgjova me vëmendje dhe mendova që do të jeni racional, konsideroj se nuk je racional, sepse kanë ndryshuar rrethanat, prej vendimit të parë kur e kemi marrë, që pastaj unë kam dërguar ankesë Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka thënë që është në përputhje me dispozitat ligjore, deri këtu jemi në rregull. Vendimi nuk është kthyer atëherë, sepse Lëvizja Vetëvendosje i ka pasur dy anëtarë, tani po i bën tre, a po ndyshojnë rrethanat këtu z. Driton?

Driton Ademi: Nuk po flas asgjë me tendencë por mendoj se Aleanca këtu, është më e diskriminuar në rastin tonë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kuvendi në asnjë moment nuk ka devijuar askund, mund të kemi debate, mospajtime por jemi brenda rregullave të Kuvendit, ju falenderoj për kontributin që e keni dhënë deri tani. E falënderoj kolegun z. Driton Ademi, për këtë sqarim briliant që e bëri para juve, vullneti i mirë është që kemi dashur t'i përfshijmë të gjitha entitetet politike në dy Komitetet e Përherëshme, të gjithë jemi pajtuar me përjashtim të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e cila ka thënë se ma keni hequr një, ne nëse ja kemi hequr një Lidhjes Demokratike të Kosovës, për t'i përfshirë të gjitha entitetet politike i'a kemi hequr edhe Lëvizjes Vetëvendosje një, me këtë veprim i kemi përfshirë të gjitha entitetet politike dhe e kemi marrë vendimin, e kemi dërguar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe është kthyer që është në rregull. Meqenëse anëtarja znj. Vildane Latifi nga Aleanca ka kaluar në Ekzekutivin e Komunës dhe në vend të saj ka ardhur z. Gjelbrim Halili si përfaqësues i Aleancës në Kuvend, deri sa kemi marrë vendimin për z. Gjelbrimin si anëtarë i ri i Komitetit për Politikë dhe Financa, komiteti ka funksionuar vetëm me gjashtë anëtarë, kur e kemi propozuar z. Gjelbrim Halili për ta plotësuar Komitetin për Politikë dhe Financa, është miratuar dhe nuk ka pasur kundërshtime nga Lidhja Demokratike e Kosovës, të gjithë kanë qenë të pajtimit me atë përbërje të Komitetit për Politikë dhe Financa, nëse Ministria nuk do ta kishte kthyer. Më momentin që Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, e ka kthyer për arsye të kuotës gjinore, jo për arsye të pjesëmarrjes së subjekteve politike, nëse e keni seriozisht këtë propozim, atëherë po e lejojmë z. Gjelbrim Halili në komitet, ndërsa në vend tëndin z. Laureat Gojnovci, propozoni njërën nga zonjat e Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtare të Kuvendit të Komunës dhe plotësohet kuota gjinore. Udhëzimi Administrativ, neni 5, pika e 1, thotë: Komiteti për Politikë dhe Financa, kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe përbërja e tij, duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteteve politike në Kuvendin e Komunës, çka është shumë e

rëndësishme, neni 3 thotë: Komiteti për Politikë dhe Financa, duhet të reflektojë barazinë gjinore në pajtim me legjislacionin në fuqi të cilën nuk guxojmë asesi ta shkelim. Nëse me të vërtetë dëshironi që të formohet Komiteti për Politikë dhe Financa, propozon njërën nga koleget tuaja në vendin tënd z. Laureat Gojnovci, z. Gjelbrim Halili mbetet dhe jemi të përfshira të gjitha subjektet politike në Komitetë për Politikë dhe Financa, nëse nuk dëshironi atëherë vazhdojmë më propozmin që ka ardhur nga Ekzekutivi i Komunës.

Laureat Gojnovci: Unë e dijë që me tërheqjen time zgjidhet ky problem dhe këtë e dëshironi, t'i jeni i gatshëm të më largoni mua nga Komiteti për Politikë dhe Financa, por jo z. Rrahim Sogojeva, kjo dëshmon sa jeni të sinqertë Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Nuk ka instrument që mundet të matë sinqeritetin e njeriut, është çështje përceptimi. Unë e kam plotësuar kuotën gjinore, për këtë arsye nuk po e propozojë z. Rrahim Sogojeva, ndërsa ju nuk e keni plotësuar kuotën gjinore. Meqenëse nuk ka diskutime tjera po e qesim në votim 'Propozimin për rishqyrtimin e vendimit dhe ndryshim-plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa me anëtaren e Kuvendit të Komunës znj. Arlinda Mekolli'.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje, gjithsej tridhjetë anëtarë.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se nuk është rishqyrtuar vendimi.

Tani po e qesim ne votim 'Propozimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës për rishqyrtimin e vendimit dhe ndryshim-plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, me anëtaren e Kuvendit të Komunës znj. Vjosa Kida Hyseni'.

U votua me: dymbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej dymbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje, gjithsej tridhjetë anëtarë.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se nuk kalon propozimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Pika e tetë (8) - Propozim për ndryshim-plotësimin e përbërjes së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për ndryshim-plotësimin e përbërjes së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale'. Hap diskutimin.

Kosovar Ademi: Kërkojmë që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Meqenëse nuk ka të tjerë që dëshirojnë të marrin fjalën, po e qesim në votim 'Propozimin e Shefit të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e ardhshme'.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se shtyhet për shqyrtim në mbledhjen e ardhshme 'Propozimi për ndryshim-plotësimin e përbërjes së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale'.

Pika e nëntë (9) - Propozim për rishqyrtimin e ndryshim-plotësimit të vendimit Nr. 15, të datës 28.01.2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për rishqyrtimin e ndryshim-plotësimit të vendimit Nr. 15, të datës 28.01.2026', është cështje teknike që ka ardhur në rishqyrtim për të larguar paragrafin 3 të vendimit, ku përmendet pagesa e aksionarëve të KRM 'Pastrimi'. Hap diskutimin.

Kosovar Ademi: Nuk kemi ndonjë koment, pajtohemi me kërkesën për ndryshimin e cekur për paragrafin 3 të vendimit Nr. 15, të datës 28.01.2026.

Driton Ademi: Funksioni i aksionarëve nuk është pjesë e strukturës së KRM 'Pastrimi', pagesa nuk ju takon dhe mendoj, se duhet të shfuqizohet.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Meqenëse nuk ka diskutime tjera e qesim në votim 'Propozimin për rishqyrtimin e ndryshim-plotësimit të vendimit Nr. 15, të datës 28.01.2026', duke e hequr paragrafin 3 të vendimit.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se u aprovua 'Propozimi për rishqyrtimin e ndryshim-plotësimit të vendimit Nr. 15, të datës 28.01.2026', duke e hequr paragrafin 3 të vendimit dhe mori:

V E N D I M

1. Me këtë ndryshim - plotësim të paragrafit tre (3) të vendimit Nr. 15, të datës 28.01.2026 bëhet pezullimi konform emailit të datës 24.04.2026 - nuk parashihet kompenzimi i përfaqësuesve të aksionarit dhe bëhet largimi i përshkrimit nga vendimi i këtij paragrafi, pjesa tjetër e vendimit, mbetet e njëjta konform vlerësimit të Ministrisë së Ekonomisë Nr. 228, të datës 13.02.2026.
2. Emërimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve nga Komuna e Fushë-Kosovës për Kompaninë Regjionale të Mbeturinave 'Pastrimi', në përbërje e cekur në vendimin Nr. 15, të datës 28.01.2026 dhe përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive të punës së këtij Komisioni, mbeten të plotëfuqishme dhe të zbatueshme konform vendimit të muajit janar 2026.
3. Mandati i Komisionit Komunal të Aksionarëve nga Komuna e Fushë-Kosovës për Kompaninë Regjionale të Mbeturinave 'Pastrimi', zgjatë dhe është i ndërlidhur me mandatin zgjedhor të Kuvendit të Komunës.

Pika e dhjetë (10) - Shqyrtimi i dytë dhe ndryshim-plotësimi i Rregullores për Taksa Komunale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtimin e dytë 'Rregulloren për Taksa Komunale', janë bërë rregullimet teknike në nenin 20 dhe nene tjera. Hap diskutimin.

Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim për aprovim në shqyrtimin e dytë 'Ndryshim-plotësimin e Rregullores për Taksa Komunale'.

Ali Ismaili: A ka ndonjë ndryshim nga shqyrtimi i parë, pse nuk është këtu ai që e ka sponzorizuar këtë rregullore dhe me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, po shfuqizohen disa rregullore tjera ndër to edhe ajo pjesa, që parasheh gjoba mandatore dhe këtu nuk janë përfshirë sanksionimet në raport me taksat komunale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pasi që nuk ka të tjerë që dëshirojnë të marrin fjalën, po e qesim në votim, në shqyrtimin e dytë 'Ndryshim-plotësimin e Rregullores për Taksa Komunale'.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se u aprovua në shqyrtimin e dytë 'Ndryshim-plotësimi i Rregullores për Taksa Komunale' dhe mori:

VENDIM

1. Për aprovimin e 'Rregullores për taksa komunale për subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.
2. Rregullorja për taksa komunale për subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e rregullimit dhe ofrimit të taksave komunale vjetore për subjektet afariste, që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja për taksa komunale për subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, me ndryshim-plotësimet e saj.

Pika e njëmbëdhjetë (11) - Shqyrtimi i dytë i Projekt-Planit Lokal për avansimin e të drejtave të komuniteteve romë dhe ashkalinjë të Komunës së Fushë-Kosovës për 2026-2029.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtimin e dytë 'Projekt-Planin Lokal për avansimin e të drejtave të komuniteteve romë dhe ashkalinjë të Komunës së Fushë-Kosovës për 2026-2029', është çështje teknike para dy muajve ka qenë në shqyrtimin e parë. Hap diksutimin.

Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim për aprovim në shqyrtimin e dytë 'Projekt-Planin Lokal për avansimin e të drejtave të komuniteteve romë dhe ashkalinjë të Komunës së Fushë-Kosovës për 2026-2029'.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pasi që nuk ka të tjerë që dëshirojnë të marrin fjalën, po e qesim në votim për aprovim në shqyrtimin e dytë 'Projekt-Planin Lokal për avansimin e të drejtave të komuniteteve romë dhe ashkalinjë të Komunës së Fushë-Kosovës për 2026-2029'.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se u aprovua shqyrtimin e dytë Projekt-Planit Lokal për avansimin e të drejtave të komuniteteve romë dhe ashkalinjë të Komunës së Fushë Kosovës për 2026-2029' dhe mori:

VENDIM

1. Për aprovimin e Planit të Veprimit Komunal për avansimin e të drejtave të komuniteteve Romë dhe Ashkali të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2026-2029'.
2. Plani i Veprimit Komunal për avansimin e të drejtave të komuniteteve Romë dhe Ashkali të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2026-2029', e cekur në pikën një të këtij vendimi,

cakton objektivat për avansimin e të drejtave të komuniteteve për periudhën tre vjeçare në territorin e komunës.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i Veprimit Komunal për avansimin e të drejtave të komuniteteve Romë dhe Ashkali të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2026-2029.

Pika e dymbëdhjetë (12) - Informatë për performancën e Komunës së Fushë Kosovës në vitin 2025.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Besoj se këtë informatë e keni marrë në materialin e mbledhjes dhe ka të bëjë me performancën e komunës në vitin 2025, në nivel të Kosovës, po edhe të dhënat për komunën tonë. Hap diskutimin nëse dikush dëshiron të marrë fjalën.

Driton Ademi: Zyrtarja për performancë është në organogram direkt me Zyrën e Kryetarit të Komunës, kështu që raporti i performacës vjen në këtë linjë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Meqenëse nuk ka të tjerë që dëshirojnë të marrin fjalën, konstatojmë që u mbylle diskutimi për këtë pikë të rendit të ditës.

Pika e trembëdhjetë (13) - Propozim për shfuqizimin e vendimit Nr. 267, të datës 03.09.2026, sipas shkresës së Ministrisë së Financave me Nr. 1758-1/2026, të datës 21.09.2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për shfuqizimin e vendimit Nr. 267, të datës 03.09.2026, sipas shkresës së Ministrisë së Financave me Nr. 1758-1/2026, të datës 21.09.2026', për arsye se ndryshojnë mjete financiare në buxhet, andaj duhet të shfuqizohet ky vendim. Hap diskutimin.

Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim për aprovim 'Propozimin për shfuqizimin e vendimit Nr. 267, të datës 03.09.2026, sipas shkresës së Ministrisë së Financave me Nr. 1758-1/2026, të datës 21.09.2026', duke u mbështetur në arsyet që u sqaruan nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Meqenëse nuk ka të tjerë që dëshirojnë të marrin fjalën, po e qesim në votim 'Propozimin për shfuqizimin e vendimit Nr. 267, të datës 03.09.2026, sipas shkresës së Ministrisë së Financave me Nr. 1758-1/2026, të datës 21.09.2026'

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se u aprovua 'Propozimi për shfuqizimin e vendimit Nr. 267, të datës 03.09.2026, sipas shkresës së Ministrisë së Financave me Nr. 1758-1/2026, të datës 21.09.2026' dhe mori:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit Nr. 267, të datës 03.09.2026, për aprovimin e Propozimit Nr. 1544, të datës 02.09.2026, për ridestinimin e mjeteve financiare në shumë prej: 450,000.00€, nga projekti kapital në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave, programi Buxhetimi me Nr. 17502, kodi i projektit Nr. 54403 'Bashkëfinancimi i Projekteve' dhe bartjen e tyre për shpenzim në Drejtorinë e Infrastrukturës, programi Infrastruktura Rrugore me Nr. 18002, për realizimin e projektit kapital për 'Asfaltimin e rrugës 'Ejup Gashi' me infrastrukturë përcjellëse në gjatësi prej 1300 metra' – në kodin e projektit Nr. 20945', sipas shkresës Nr. 1758-1/2026, të datës 21.09.2026 të Ministrisë së Financave.

Pika e katërmbëdhjetë (14) - Propozim për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për asfaltimin e rrugës 'Ejup Gashi'.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për asfaltimin e rrugës 'Ejup Gashi', materialin e keni marrë, fjala për Drejtorin e Buxhetit dhe Financave.

Drejtori për Buxhet dhe Financa: E kemi ndryshimin tek 'Kodi i bashkëfinancimit' ku janë planifikuar mjete financiare në shumë prej: 1,500,000.00€, këto kanë qenë të dedikuara për 'Projektin e Impiantin e trajtimin e ujërave të zeza' dhe për të mos shkuar kjo shumë e mjeteve financiare në suficit kemi kërkuar nga Kuvendi i Komunës, që kjo pjesë e shumës prej: 373,500.00€, të tranferohet tek rruga 'Ejup Gashi', është kod me 25%, nuk shkon në Ministri të linjës por direkt në Qeverinë e Kosovës, kjo është arsyeja.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit drejtor, meqenëse nuk ka të tjerë që dëshirojnë të marrin fjalën, po e qesim në votim 'Propozimin për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare në shumë prej: 373,500.00€ për asfaltimin e rrugës 'Ejup Gashi'.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për' asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se u aprovua votua 'Propozimi për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare në shumë prej: 373,500.00€ për asfaltimin e rrugës 'Ejup Gashi' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 295, të datës 25.09.2026, për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare në shumë prej: 373,500.00€, nga projekti kapital në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave, nën - programi Buxhetimi me Nr. 17502, kodi funksional 0112, kategoria ekonomike Investime Kapitale Nr. 30, burimi i financimit Nr. 10, kodi i projektit Nr. 54403 'Bashkëfinancimi i projekteve të ndryshme sipas prioritetit të komunës, impianti i ujërave të zeza dhe projektet nga donatorët dhe Ministritë e linjës', përqindja e transferit 24.90%, të cilat transferohen për shpenzim në Drejtorinë e Infrastrukturës, nën – programi Infrastruktura Rrugore me Nr. 18002, kodi funksional 0451, në kategorinë ekonomike Investime Kapitale Nr. 30, burimi i financimit Nr. 10, kodi e projektit Nr. 20945, për realizimin e projektit kapital për 'Asfaltimin e rrugëve në Lismir: Tahir Mehaj dhe Ejup Gashi'.
2. Mjetet financiare të transferuara / rialokuara në programet buxhetore dhe kodet e projekteve përkatëse, do të shfrytëzohen për realizimin e projektit kapital të evidentuar në paragrafin një (1) të këtij vendimi, me Nr. 20945.

Pika e pesëmbëdhjetë (15) - Propozim për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për arsim në nën - programet buxhetore të shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për arsim në nën - programet buxhetore të shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës'. Hap diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim për aprovim 'Propozimin për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për arsim në nën - programet buxhetore të shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës', për plotësimin e nevojave në shkollat e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë, meqenëse nuk ka të tjerë që dëshirojnë të marrin fjalën, po e qesim në votim 'Propozimin për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për arsim në nën - programet buxhetore të shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës'.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për' asnjë votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej gjashtëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se u aprovua 'Propozimi për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për arsim në nën - programet buxhetore të shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 296, të datës 25.09.2026, për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare në shumë prej: 256,000.00€, me përqindje 15%, nga nën-programet buxhetore si vijon:

1.1 Nën-programi Arsimi Fillor i Mesëm i Ulët, me Nr. 93030, kodi funksional 0912, në kategorinë ekonomike Investime Kapitale Nr. 30, burimi i financimit Nr. 10, kodi i projektit Nr. 20867, 'Renovimi i Objekteve Shkollore' - për shkollat: Bajram Curri, Mihal Grameno, Mihal Grameno Aneksi 2, Daut Bogujevci, Vëllezërit Frashëri, Zejnel Salihu dhe Hivzi Sulejmani, në shumën e mjeteve financiare prej: 200,000.00€;

1.2 Nën-programi Arsimi Fillor i Mesëm i Ulët, me Nr. 93030, kodi funksional 0912, në kategorinë ekonomike Investime Kapitale Nr. 30, burimi i financimit Nr. 21, kodi i projektit Nr. 20867, 'Renovimi i Objekteve Shkollore' - për shkollat: Bajram Curri, Mihal Grameno, Mihal Grameno Aneksi 2, Daut Bogujevci, Vëllezërit Frashëri, Zejnel Salihu dhe Hivzi Sulejmani, në shumën e mjeteve financiare prej: 56,000.00€ dhe

1.3 Mjetet financiare në shumën prej: 200,000.00€ nga burimi i financimit 10 dhe mjetet financiare në shumën prej: 56,000.00€ nga burimi i financimit 21 - transferohen për shpenzim në nën - programin Arsimi Fillor i Mesëm i Ulët, me Nr. 93030, kodi funksional 0912, në kategorinë ekonomike Mallëra dhe Shërbime Nr. 13, nga burimet e financimit Nr. 10 dhe Nr. 21, të cekura në paragrafin një, nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2, të këtij vendimi.

2. Mjetet financiare të transferuara / rialokuara në programet buxhetore dhe kodet përkatëse, do të shfrytëzohen për plotësimin e nevojave për mallëra e shërbime të planifikuar në kuadër të Drejtorisë së Arsimit në nën - programet e evidentuar në paragrafin një (1) të këtij vendimi për shumë e cekur në vendim.

Pika e gjashtëmbëdhjetë (16) - Propozim për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për nën - programin 'Infrastruktura Rrugore'.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për nën - programin 'Infrastruktura Rrugore'. Hap diskutimin.

Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim për aprovim 'Propozimin për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për nën - programin 'Infrastruktura Rrugore'.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë, meqenëse nuk ka të tjerë që dëshirojnë të marrin fjalën, po e qesim në votim për aprovim 'Propozimi për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për nën - programin 'Infrastruktura Rrugore'.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej gjashtëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se u aprovua 'Propozimi për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare për nën - programin 'Infrastruktura Rrugore' dhe mori:

VENDIM

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 297, të datës 25.09.2026, për transferimin / rialokimin e mjeteve financiare në shumë prej: 162,777.00€, nga projekti kapital në Drejtorinë e Infrastrukturës, nën - programi Infrastruktura Rrugore me Nr. 18002, kodi funksional 0451, në kategorinë ekonomike Investime Kapitale Nr. 30, burimi i financimit Nr. 10, kodi e projektit Nr. 20975, 'Asfaltimi i rrugës Prekadini te Parku Rekreativ te Pishat në fshatin Sllatinë e Vogël', me përqindje prej 6.57% - transferohen për shpenzim në Drejtorinë e Infrastrukturës, nën - programi Infrastruktura Rrugore me Nr. 18002, kodi funksional 0451, në kategorinë ekonomike Mallëra dhe Shërbime Nr. 13, burimi i financimit Nr. 10.
2. Mjetet financiare të transferuara / rialokuara në programin buxhetore nga kodi përkatës, do të shfrytëzohen për plotësimin e nevojave për mallëra e shërbime në nën - programi Infrastruktura Rrugore me Nr. 18002, për shumën e evidentuar në paragrafin një (1) të këtij vendimi.

Pika e shtatëmbëdhjetë (17) - Propozim për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 75,000€, për realizmin e projektit dy vjeçar për ndërtimin e objektit me karakter shoqërorë 'Shtëpi për të pame' me objekte përcjellëse në Fushë-Kosovë në lagjen e komuniteteve 029.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 75,000€, për realizmin e projektit dy vjeçar për ndërtimin e objektit me karakter shoqërorë 'Shtëpi për të pame', me objekte përcjellëse në Fushë-Kosovë në lagjen e komuniteteve 029'. Hap diskutimin.

Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim për aprovim 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 75,000€, për realizmin e projektit dy vjeçar për ndërtimin e objektit me karakter shoqërorë 'Shtëpi për të pame', me objekte përcjellëse në Fushë-Kosovë në lagjen e komuniteteve 029', meqë plotësimi i nevojave për qytetarët e komunës nga radhët e komunitetit jo shumicë në Fushë-Kosovë, me këtë objekt është i domosdoshëm.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë, meqenëse nuk ka të tjerë që dëshirojnë të marrin fjalën, po e qesim në votim për aprovim 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 75,000€, për realizmin e projektit dy vjeçar për ndërtimin e objektit me karakter shoqërorë 'Shtëpi për të pame', me objekte përcjellëse në Fushë-Kosovë në lagjen e komuniteteve 029'.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për' asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se u aprovua 'Propozimi për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 75,000€, për realizmin e projektit dy vjeçar për ndërtimin e objektit me karakter shoqërorë 'Shtëpi për të pame', me objekte përcjellëse në Fushë-Kosovë në lagjen e komuniteteve 029' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Rekomandimit Nr. 300, të datës 29.09.2026, për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 75,000.00€, nga buxheti i komunës për realizimin e projektit dy vjeçarë për ndërtimin e objektit me karakterë shoqërorë - 'Shtëpisë për kryerjen e të Pameve, me objekte përcjellëse tjera në lagjen 029 në Fushë-Kosovë', prej nën - programi Buxhetimi me Nr. 17502, kodi funksional 0112, kategoria ekonomike Investime Kapitale Nr. 30, burimi i financimit Nr. 10, kodi i projektit Nr. 54403 'Bashkëfinancimi i projekteve të ndryshme sipas prioritetit të komunës, impianti i ujërave të zeza dhe projektet nga donatorët dhe Ministritë e linjës', me participimin edhe të qytetarëve të lagjeve 028 dhe 029 të Fushë-Kosovës.
2. Mjetet financiare të lejuara për ndërtimin e objektit të evidentuar në paragrafin një (1), të këtij vendimi, shfrytëzohen për realizimin e projektit kapital në interes të përgjitshëm të komuniteteve jo shumicë - komuniteteve romë, ashkalinjë dhe egjiptian në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Pika e tetëmbëdhjetë (18) - Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Në qoftë se nuk ka dikush të shtojë diçka tek pika 'Të Ndryshme', konstatojë se është mbyllur mbledhja e sotme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falenderoi të pranishmit për pjesëmarrjen në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 15:30 minuta.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani